



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:088230
Datë: 17.06.2021
Numri i dokumentit: 01896390

P.nr.479/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica në çështjen penale ndaj të akuzuarve M. M. dhe K. M. që të dy nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 402 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1108/2020 të datës 29.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 31.05.2021 mori dhe shpalli ndërsa me datë 17.06.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

M. M., nga babai R. dhe nëna H., i lindur me datë 11.05.1979 në fshatin Busavatë, Komuna e Kamenicës ndërsa me vendbanim në fshatin Përlepnice, Komuna e Gjilanit, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

K. M., nga babai F. dhe nëna H., e lindur R., i lindur me datë 26.02.1996, në Gjilan, me vendbanim në fshatin Përlepnice, Komuna e Gjilanit, i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTOR

Sepse me datë 24.07.2020, rreth orës 20:23 minuta në Gjilan, në rrugën “Haqif Tetova”, të akuzuarit e lartcekur në bashkëkryerje kanë sulmuar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare dhe atë zyrtarët policor A. O. dhe S. B. ashtu që fillimisht i akuzuari M. M. në gjendje të dehur duke drejtuar veturën e markës “Frontera”, me numër të regjistrimit 681-KS-392, me pasqyrën e anës së majtë e godet këmbësorin-tani të dëmtuarin zyrtarin policor A. O. dhe nga kjo goditje i njëjti rrëzohet për toke ku edhe pëson lëndime trupore me këtë rast zyrtarët policor kërkojnë që i akuzuari M. M. të ndalojë veturën e tij, i njëjti e ndalon dhe ai së bashku me pasagjerët e tij-tani të akuzuarin K. M. fillimisht i fyejnë me fjalë të ndryshme ofenduese zyrtarët policor ku ndër të tjera “jav... policinë e nonës”, “na policisë së shkavit sja u këna q... nonën e lëmo juve” e më pas i sulmojnë ku i akuzuari Musa Maliqi me duar nga prapa e kap zyrtarin policor S. B. ndërsa i akuzuari K. M. i vërsulet që ta godas mirëpo ndërhyr pasagjeri tjetër B. D. dhe e largon gjithashtu më pas ndërhyr edhe zyrtarët policor të cilët ndërkohë arrin për asistim dhe të njëjtit i arrestojnë kështu që të akuzuari veprimet e tyre i kanë drejtuar kundër të mirës juridike që konsiston në rrezikimin e integritetit trupor dhe autoritetin e zyrtarit në kryerjen e detyrave zyrtare.

-Me çka kanë kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 402 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 38,39,40,42,43,44,69 dhe 70 të KPRK-ës dhe neneve 359,360,361,362 dhe 365 të KPP-ës, të akuzuarit e lartcekur:

I GJYKON

Me burgim në kohëzgjatje prej nga 180 (njëqindetëdhjetë) ditëve për secilin prej tyre veç e veç, të cilat dënime komfor nenit 44 të KRPK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarve u zëvendësohen në dënime me gjobë në shumë prej nga 1000 € (njëmijë euro), të cilat obligohen ti paguajnë në afat prej 3 (tre) muajsh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimet me gjobë atëherë dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen secilit prej tyre veç e veç në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo € (njëzet euro) do t'iu caktohet nga një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KRPK-ës të akuzuarve të lartcekur koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 24.07.2021 deri me datë 10.08.2020 do tu llogaritet secilit prej tyre veç e veç në dënimin e shqiptuar me gjobë.

Obligohen të akuzuarit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 30.07.2020, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1108/2020, kundër ndaj të akuzuarve M. M. dhe K. M., që të dy nga fshati Përlepnice, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 402 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës.

Gjykata me krijimin e kushteve ligjore, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilat janë administruar provat personale dhe materiale si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave materiale dhe personale është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila iu bie në barrë sipas aktakuzës lëndore ngase ditën kritike i akuzuari M. M. kishte goditur fillimisht me pasqyrën e veturës të dëmtuarin A. O., të cilit më pas i dëmtuari në cilësi të personit zyrtar i vihet pas, pas disa metrave i akuzuari M. M. e ndalon veturën dhe në momentin kur i dëmtuari prezantohet si policë dhe i tregon se i akuzuari e kishte goditur me pasqyrë, fillon konfrontimi fizik fillimisht mes të akuzuarit M. M. të cilit më pastaj i bashkangjitet edhe i akuzuari tjetër Kelmend Maloku me të dëmtuarin e lartcekur, të cilët fillimisht i fyejnë personat zyrtar me fjalë ofenduese ashtu që të dëmtuarit kërkojnë asistencë policore dhe pas arritjes së tyre ishte bërë arrestimi i të akuzuarve, por që gjatë arrestimit të tyre të akuzuarit kishin rezistuar duke i detyruar policët që forcërisht me një forcë ekuivalente ti vënin nën kontroll për ti dërguar në stacion policor, e se ka pasur shtyrje dhe kontakt fizik në mes të akuzuarve dhe të dëmtuarve vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve të cilat në mënyrë të përpiktë përshkruajnë rrjedhën e ngjarjes

dhe se situata kishte qenë e tensionuar vërtetohet nga deklarata e vetë të dëmtuarit A. O. i cili ka deklaruar se kishte mbajtur dorën tek arma e tij zyrtare ndërsa dëshmitari I. R. ka deklaruar se nëse nuk do të kishin arritur në vend të ngjarjes atëherë polici i kishte pasur dorën në armën e tij zyrtare atëherë i njëjti ose do të përfundonte në spital ose në burg, rrethana këto të vërtetohen edhe nga provat materiale para se gjithash me dëshmi të fotografive të të akuzuarve nga alkool testi që vërteton se të njëjtit kishin konsumuar alkool dhe nuk kishin qenë në gjendje që ti kontrollonin veprimet e tyre, andaj ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit ti shpallë fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

I akuzuari M. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vetëm kërkon drejtësi nga gjykata që të vendoset sipas ligjit.

I akuzuari K. M. në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta liroj nga akuza dhe se nga dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar deri diku gjendja faktike por jo e gjitha.

2. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë në bazë të:

- Dëgjimit e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit S. B.,
- Dëgjimit e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit A. O.,
- Dëgjimit të dëshmitarit B. D.,
- Dëgjimit të dëshmitarit I. B.,
- Dëgjimit të dëshmitarit I. R.,
- Dëgjimit të dëshmitarit F. K.,
- Dëgjimit të dëshmitarit E. G.,
- Administrimit të provave materiale dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-0757, deklarata e të dëmtuarit A. O. e dhënë në prokurori me datë 27.07.2020, deklarata e të dëmtuarit S. B. e dhënë në prokurori me datë 27.07.2020, raportet e policëve me datë 24.07.2020, CD-ja me video incizim, raportet e zyrtarëve policor I. R. dhe I. B., raporti mjekësor me numër të protokollit 16168 i datës 24.07.2020 në emër të A. O., raporti mjekësor me numër të protokollit 16167 i datës 24.07.2020 në emër të K. M., foto dokumentacioni, raporti mbi tërheqjen e veturës,
- Mbrojtjes së të akuzuarit M. M. dhe
- Mbrojtjes së të akuzuarit K. M..

2.1. Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit S. B.

I dëmtuari S. B. në cilësinë e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë në detyrë zyrtare së bashku me kolegun e tij të dëmtuarin A. O. dhe atë në rrugën “Haqif Tetova” në Gjilan, e cila është rrugë një kahëshe, ashtu që ai kishte qenë në anën e djathë në trotuar, kur kishte ardhur një veturë e markës “Opel Frontera” me një shpejtësi të theksuar duke bërë lëvizje herë në anën e djathë e herë në anën e majtë dhe se kishte dëgjuar një goditje dhe një të sharë nga një person i cili kishte thënë “nënë...”, por që i dëmtuari kishte menduar se mund të jetë një koleg i tyre ose një shok i të dëmtuarit A., ngase edhe ai posedonte një veturë të llojit të njëjtë, por që kur ishte kthyer e kishte parë të rrëzuar në tokë kolegun e tij të dëmtuarin A. O. i cili në ato momente kishte bërë “ndal ndal” e më pas i njëjti ishte nisur në drejtim të veturat i cili kishte ndaluar pas 10 – 12 metrave në mënyrë të vullshme, ku i dëmtuari A. O. ishte ofruar tek vetura në fjalë dhe nga aty kishte dalur i akuzuari M. M. ndërsa më pas kishte shkuar afër tyre edhe i dëmtuari S. B. të cilin më pas i akuzuari M.

M. e kishte kapur për krahu dhe i kishte thënë “unë ty po të njoh”, por që i dëmtuari S. i kishte treguar se ata ishin persona zyrtar dhe se i njëjti duhet të kthehet në veturë dhe ta fikë të njëjtën për arsye që të mbahet situata nën kontroll ngase personat të cilët kishin qenë në veturë vazhdimisht kishin qenë duke i sharë dhe ofenduar zyrtarët policor dhe kishin tentuar që të dilnin nga vetura që ti sulmonin ndërsa dëshmitari B. D. kishte dalur nga vetura dhe kishte bërë përpjekje për ti ndarë dhe ndaluar ngase i akuzuari K. M. kishte hipur mbi veturë dhe kishte tentuar që ti godiste zyrtarët policor, por që situata ishte vënë nën kontroll vetëm pasi që të njëjtit kishin kërkuar asistencë nga zyrtarët e tjerë policor nga ku kishin ardhur Njësia Speciale e Policisë së Kosovës ndërsa pas arrestimit të tyre ai kishte vërejtur se njëri nga të akuzuarit kishte qenë në gjendje të dehur dhe nuk kishin mundur që ti merrnin deklaratën. Tutje i dëmtuari S. B. ka deklaruar se M. M. fillimisht u kishte thënë që ta lironin sepse po të dilnin nga vetura ndonjëri nga pasagjerët atëherë do të bëhet problem dhe se nuk i kishte respektuar urdhrat e marra nga zyrtarët policor e po ashtu i akuzuari M. e kishte shtyrë të dëmtuarin ndërsa i akuzuari K. M. në vazhdimësi kishte provuar që ta godiste mirëpo nuk ia kishte arritur qëllimit por se nuk e kishte parë asnjërin nga të akuzuarit që të kishte goditur të dëmtuarin A. O. por që i njëjti lëndimet i kishte pësuar si pasojë e aksidentit të goditjes së vetës së tij.

2.2 Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit A. O.

I dëmtuari A. O. në cilësinë e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë në detyrë zyrtare dhe atë ditë kishte qenë ora policore nga ora 21:00, në rrugën “Haqif Tetova”, ku ai dhe i dëmtuari tjetër S. B. kishin qenë në drejtim të furrës së bukës “Aroma”, kur në ato momente kishte ardhur një veturë nga kahu i kundërt i rrugës dhe me pasqyrën e veturës e kishte goditur të dëmtuarin atë me ç’rast i njëjti i kishte bërë me dorë që të ndalonin dhe vetura pas disa metrave kishte ndaluar ku i akuzuari K. M. e kishte sharë me fjalë të rënda nga brenda veturat ashtu që i dëmtuari me hapa të përshpejtuar ishte ofruar afër veturës së tyre ku edhe i kishte prezantuar ID e zyrtarit policor të akuzuarit M. M. dhe në ato çaste ishte ofruar edhe i dëmtuari S. B., e më pas i akuzuari M. M. i kishte thënë të dëmtuarit A. se atë nuk e njihte ndërsa të dëmtuarin tjetër S. B. se po e njihte mirë por që në ato momente situatën e kishte tensionuar i akuzuari Kelmend Maloku i cili gjatë gjithë kohës kishte sharë e ofenduar por që nuk kishte mundur që të dilte nga vetura pasi që e njëjta kishte qenë me një palë dyer andaj i dëmtuari A. O. i kishte thënë të akuzuarit M. M. që ta fikte veturën dhe t’ia dorëzonte çelësat e veturës, ndërsa i akuzuari K. M. kishte ndërhyrë duke i thënë të akuzuari M. “o bimi mu çelësat e une ia boj nonën i shkeli qetu”, e me të parë këtë situatë, i dëmtuari A. kishte kërkuar asistencë policore nga Stacioni Policor në Gjilan, e në ato momente e kishte parë se i akuzuari M. M. e kishte kapur për duar të dëmtuarin S. B. dhe i kishte thënë që të largohej prej tij por që nuk kishte vonuar shumë dhe kishin arritur policët e tjerë dhe situata ishte futur nën kontroll. Tutje ka shtuar se edhe i akuzuari K. M. kishte dalur nga vetura dhe kishte tentuar që ti sulmonte të dëmtuarit ndërsa lëndimet që i kishte pësuar i dëmtuari A. O. kishin qenë si pasojë e goditjes me veturë e jo si pasojë e konfrontimit me të akuzuarit, ngase me të njëjtit vetëm ishin shtyrë dhe se nuk kishte pasur goditje mes tyre.

2.3 Deklarata e dëshmitarit Blerim Dërmaku

Dëshmitari B. D. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë në veturë së bashku me të akuzuarit M. M. dhe K. M. ashtu që kur kishin hyrë rrugës për te Ambulanca kishin hasur në dy persona të cilët kishin qenë duke qëndruar në këmbë në trotuar, ku i akuzuarit K. M. u kishte thënë nga brenda veturës që të largoheshin nga rruga, si pasojë e së cilës të njëjtit kishin filluar që të vinin mbrapa veturës, e kur këtë e kishte vërejtur i akuzuari M., ai e kishte ndaluar veturën ashtu që të dëmtuarit në këtë rast ishin afruar afër veturës dhe u kishin thënë që të ndalonin dhe të dilnin jashtë veturës, e pas kësaj i akuzuari M. M. kishte dalur nga vetura, kurse ai dhe i akuzuari K. M. kishin

qëndruar në veturë, e deri sa i akuzuari M. po bisedonte me të dëmtuarin, ai kishte vërejtur se situata po shkonte duke u tensionuar por që në ato momente ata nuk e kishin ditur se të njëjtit ishin zyrtarë policor dhe se nuk ishte në njohuri nëse të njëjtit ishin prezantuar si zyrtarë policor, e më pas kishte ndërhyrë i akuzuari K. M. i cili kishte dalur jashtë veturës por që nuk e kishte dëgjuar të njëjtit të shante ose të ofendonte ndërsa njëri nga të dëmtuarit u ishte drejtuar me fjalët “hyni brenda se iu hongër dreqi ua nxorra zemrën” ndërsa tjetri i dëmtuar e kishte nxjerr revolen, andaj në ato çaste dëshmitari B. D. kishte dalur nga vetura dhe kishte shkuar e kishte kapur të akuzuarin K. M., e po ashtu edhe i dëmtuari A. O. në vazhdimësi kishte tentuar që ta qetësonte situatën duke iu thënë të akuzuarve që të futeshin në veturë, e pas gjithë kësaj ai e kishte dëgjuar të dëmtuarin S. B. që kishte thënë se ai ishte polic ku edhe më pas kishte arritur ta fuste në veturë të akuzuarin K. ndërsa i akuzuari M. M. kishte qëndruar jashtë veturës duke biseduar me tone të larta me të dëmtuarit por që nuk kishte njohuri nëse i akuzuari M. M. të kishte goditur me pasqyrën e veturës të dëmtuarin A. ngase atë ditë ati dhe të akuzuarit në këtë çështje penalo juridike kishin konsumuar alkool. Tutje ka shtuar se pas gjithë kësaj situatë aty kishin ardhur Njësia Speciale e Policisë së Kosovës dhe se në ato momente i akuzuari M. M. kishte qenë jashtë veturës ndërsa ai dhe i akuzuari K. M. kishin qenë brenda në veturë dhe në gjithë këtë situatë të krijuar ai nuk kishte parë as të akuzuarit dhe as të dëmtuarit që të kishin goditur njëri tjetrin.

2.4 Deklarata e dëshmitarit I. B.

Dëshmitari I. B., i cili njëherit është edhe zyrtarë policor pranë Stacionit Policor në Gjilan, ka deklaruar se ditën kritike pasi që kishin pranuar thirrjen për asistencë, kishin shkuar në vendin e ngjarjes dy persona kishin qenë të prangosur ndërsa njëri prej tyre nuk kishte qenë i prangosur por që kishte qenë nën vëzhgimit e njësitit të reagimit të shpejtë dhe se në momentin e arritjes këta persona kishin qenë të qetë, e më pas dy prej tyre i kishin shoqëruar për në Stacion Policor ndërsa njërin prej tyre e kishin dërguar për tretman mjekësor dhe se tek të njëjtit nuk kishte parë ndonjë ndërveprim fizik apo verbal, ashtu që më pas në Stacion Policor të njëjtëve u ishte bërë alkool testi nga të cilat teste kishte rezultuar se të njëjtit kishin përdorur alkool, ndërsa njëri prej tyre nuk kishte pas njohuri se si bëhej alkool testi andaj edhe e kishin lënë që të njëjtit ti bënin alkool testin me urdhër të prokurorit të shtetit. Tutje ka shtuar se në këtë rast ata ishin ftuar për asistencë nga kolegët e tyre ngase të njëjtit kishin pasur mosmarrëveshje verbale me disa persona, ashtu që kolegët e tyre të dëmtuarit kishin qenë shumë të shqetësuar, por që nuk kishte njohuri nëse të njëjtit kishin qenë të lënduar, por që të dëmtuarin A. O. e kishin dërguar për tretman mjekësor, ndërsa me qenë se ai kishte arritur i fundit në vendin e ngjarjes, ai nuk kishte parë nëse ndonjëri nga të dëmtuarit në duar të mbante revolen e punës.

2.5 Deklarata e dëshmitarit I. R.

Dëshmitari I. R. i cili njëherit është edhe zyrtarë policor pranë Stacionit Policor në Gjilan, ka deklaruar se ditën kritike kishte qenë në detyrë së bashku me oficerët policor E. G. dhe F. K. dhe kishin pranuar thirrjen për asistencë nga kolegët e tyre ashtu që me të arritur në vendin e ngjarjes kishin hasur në një numër të madh të qytetarëve të cilit ishin duke shikuar se çfarë po ndodhte si dhe të akuzuarit dhe të dëmtuarit të cilët ishin duke u shtyer në mes vete pastaj të njëjtit kishin ndërhyrë për ti ndarë dhe gjatë kësaj kohe të akuzuarit në vazhdimësi kishin kërcënuar të dëmtuarit me tone të larta ashtu që oficerët policor ishin ndarë tek secili i dyshuar në këtë rast dhe kishin bërë arrestimin e tyre, ku të njëjtit gjatë arrestimit kishin rezistuar edhe andaj tyre deri në atë masë sa që atyre i është dashur që të përdorin goditjet hutuese me caqe primare në muskuj e cila është pjesë e futjes në kontroll nga ana e policisë në rastet kur ka rezistencë aktive, njëri nga të akuzuarit kishte qenë brenda në veturë dhe gjatë gjithë kohës i kishte goditur me këmbë zyrtarët policor deri në momentin kur kishin arritur që ta neutralizonin dhe ta fusnin në kontroll për ta dërguar më pas në Stacion Policor, ndërsa në gjithë këtë situatë ai nuk kishte

parë që ndokush të kishte goditur ndokënd por që ka deklaruar se nëse në këtë rast nuk do të arrinin me kohë që të intervenonin atëherë do të mund të shkaktohej ndonjë pasojë më e madhe.

2.6 Deklarata e dëshmitarit Fidan Kurtalani

Dëshmitari F. K. i cili njëherit është edhe zyrtarë policor pranë Stacionit Policor në Gjilan, ka deklaruar se ditën kritike kur kishte ndodhur ky rast, ai kishte qenë në orar të punës së bashku me kolegët e tij I. R. dhe E. G., kur në radio kishin dëgjuar që dy koleg të tyre me rroba civile kishin kërkuar asistencë në lagjen “Dardania” afër ambulancës, të cilës thirrje të njëjtit i ishin përgjigjur menjëherë dhe me të arritur kishin hasur në një numër të madh të qytetarëve duke shikuar një veturë e cila kishte qenë e ndaluar në mes të rrugës afër së cilës kishin qenë kolegët e tyre policor me rroba civile si dhe njëri nga të akuzuarit kishte qenë duke i rezistuar policit ashtu që dëshmitari F. së bashku me kolegët e tij kishin filluar që ta merrnin situatën nën kontroll, ku ai personalisht ishte marrë me vozitësin e veturat por që nuk i ishte kujtuar se cili kishte qenë dhe se gjatë arrestimit kishte hasur në rezistencën e tij aktive, ashtu që të njëjtit i kishte ndihmuar kolegu i tij I. R. në vënien e prangave ndaj të akuzuarit, të cilët më pas i kishin dërguar në Stacion Policor por që gjatë gjithë kësaj situatë të krijuar ai nuk kishte dëgjuar ndonjë kërcënim ngase e gjitha kishte ndodhur shumë shpejt por që e kishte parë të akuzuarin M. M. i cili e kishte shtyrë zyrtarin policor dhe nuk u kishte bindur urdhrave të tij.

2.7 Deklarata e dëshmitarit E. G.

Dëshmitari E. G. i cili njëherit është edhe zyrtarë policor pranë Stacionit Policor në Gjilan ka deklaruar se ditën kritike kur kishte ndodhur ky rast, ai kishte qenë në orar të punës së bashku me kolegët e tij zyrtarët policor I. R. dhe F. K., me ç’rast kishin dëgjuar në radion e tyre një thirrje për asistencë nga disa zyrtarë policor të cilët ndodheshin në lagjen “Dardania” afër ambulancës, andaj të njëjtit ishin nisur në atë drejtim, ku me tu afruar në vend të ngjarjes kishin hasur në një numër të madh të qytetarëve të cilët ishin duke shikuar një veturë të ndaluar, ku disa persona ishin duke u ballafaquar me disa zyrtarë policor me rroba civile ashtu që më pas ai së bashku me kolegët e tij kishin ndërhyrë për ti arrestuar dhe dërguar të akuzuarit në stacion policor, por që gjatë kohe nuk kishte dëgjuar ndonjë fjalë kërcënuese nga të akuzuarit, përpos faktit se njëri ka të akuzuarit me rastin e arrestimit kishte rezistuar kurse personin të cilin e kishte arrestuar dëshmitari E. nuk kishte rezistuar por që nuk i është kujtuar se cili nga të akuzuarit kishte qenë.

2.8 Mbrojtja e të akuzuarit M. M.

I akuzuari M. M. në mbrojtjen e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike së bashku me të akuzuarin K. M. si dhe dëshmitarin B. D. ishin takuar tek Motel “Europa” në Gjilan ku kishin pirë nga një pije alkoolike dhe më pas ishin nisur në drejtim të Gjilanit, ku pasi që kishin mbërritur deri sa po kalonin afër furrë së bukës “Aroma” në drejtim të ambulantes, kishin dëgjuar një zë që po bërtiste ashtu që kishte shikuar në pasqyrë dhe kishte vërejtur se një person ishte duke vrapuar pas tyre andaj edhe kishte ndaluar veturën, e me të ndaluar aty kishte ardhur një person i cili nuk u kishte treguar asnjë dokument me të cilin do të dëshmonte se ishte zyrtar policor dhe se aty kishte filluar fjalosja por që nuk kishte pasur fjalë ofenduese ndërsa i akuzuari K. M. kishte tentuar të dal nga vetura për të parë se çfarë po ndodhte ngase në ato momente asnjëri nga të akuzuarit nuk e dinte se personi që i kishte ndaluar ishte zyrtar policor, e më pas gjatë gjithë mosmarrëveshjes së krijuar i dëmtuari nuk e kishte sharë e as fyer të akuzuarin M. M. por vetëm e kishte parë që i njëjti ishte shtyer me të akuzuarin K. M. dhe i akuzuari M. M. kishte menduar se ata në mes vete kanë ndonjë problem të më hershëm ashtu që i akuzuari M. M. kishte dal nga vetura i pari ngase kishte qenë ai që kishte vozitur veturën dhe se me personin e dëmtuar nuk kishte mundur që të bisedonte fare ngase posa ishte ofruar

menjëherë kishin filluar sharjet verbale, ku i dëmtuari gjatë kësaj kohe në duar kishte revolen, e më pas kishin ardhur zyrtarë të tjerë policor të cilët i kishin arrestuar dhe i kishin dërguar në Stacion Policor ku i akuzuari M. kishte refuzuar që të deklarohet, por që në gjithë këtë situatë të krijuar ai ka deklaruar se nuk është e vërtetë që ai të kishte goditur me pasqyrën e veturës së tij të dëmtuarin A. O. dhe se nuk e dinë arsyen se përse i dëmtuari kishte vrapsuar pas veturës së tij e po ashtu nuk e dinte se përse zyrtari policor kishte mbajtur në duar revolen zyrtare dhe se ai personalisht nuk kishte rezistuar gjatë momentit të arrestimit ngase i kishte kontrolluar veprimet e tija ndërsa sa i përket deklaratës së të dëmtuarit se ai e kishte kapur për krahu ka shtuar se nuk është e vërtetë që ai ta ketë bërë këtë.

2.9 Mbrojtja e të akuzuarit K. M.

I akuzuari K. M. me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij ka deklaruar se dëshiron që ta shfrytëzoj të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje.

3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata komfor nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të njëjtëve shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast gjykata ka ardhur në përfundim se mbrojtjes së të akuzuarve të dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk duhet t'iu falet besimi, ngase të njëjtat nuk janë në harmoni të plotë edhe me provat e tjera personale dhe materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër nga ajo për të cilën të akuzuarit kanë pretenduar ndërsa në anën tjetër besimi duhet t'iu falet deklaratave të të dëmtuarëve si dhe dëshmitarëve meqenëse të njëjtat janë në harmoni të plotë njëra me tjetrën si dhe provat e administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe njëkohësisht të njëjtat kanë lidhshmëri logjike, kohore dhe janë bindëse dhe të qarta.

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata gjeti se në këtë çështje penale juridike nuk ishte kontestues fakti se me datë 24.07.2020, rreth orës 20:23 minuta, në rrugën "Haqif Tetova" në Gjilan, kishte ardhur deri tek një mosmarrëveshje në mes të të akuzuarve M. M. e K. M. si dhe të dëmtuarve zyrtarë policor A. O. dhe S. B. ngase një gjë e tillë vërtetohet në bazë të provave personale dhe materiale të cilat gjykata i administroj në seancat e shqyrtimit gjyqësor si dhe vet deklaratave të të akuzuarve të dhëna në statet e mëhershme të procedurës penale të cilët për asnjë moment nuk e kanë mohuar faktin se me të dëmtuarit natën kritike kanë pasur mosmarrëveshje, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se natën kritike të akuzuarit kishin konsumuar alkool sepse një gjë e tillë nuk ishte kontestuar as nga vet të akuzuarit gjithashtu gjykata gjeti se nuk ishte kontestues as fakti se pasi që i akuzuari M. M. e kishte ndalur veturën e tij dhe aty kishin mbërritur të dëmtuarit mes tyre dhe të akuzuarve kishte filluar një mosmarrëveshje fillimisht verbale sepse ky fakt nuk është kundërshtuar as nga të akuzuarit e as nga të dëmtuarit mirëpo gjykata gjeti se në këtë çështje penale juridike kontestuese ishte se nëse pasi që i akuzuari M. M. fillimisht me pasqyrën e veturës së tij e kishte goditur të dëmtuarin A. O. e pas ndalimit të veturës së tyre në mes tyre dhe të dëmtuarëve kishte pasur shtyrje dhe kanosje serioze për sulm ndaj të dëmtuarve si elemente të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 402 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata këto fakte kontestuese i zgjodhi duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarit S. B. të dhënë në cilësinë e dëshmitarit i cili kishte deklaruar se ditën kritike kishte qenë në detyrë zyrtare së bashku me

kolegun e tij të dëmtuarin A. O. dhe atë në rrugën “Haqif Tetova” në Gjilan, pranë tyre kishte kaluar një veturë e markës “Opel Frontera” me një shpejtësi të theksuar duke bërë lëvizje herë në anën e djathtë e herë në anën e majtë dhe se kishte dëgjuar një goditje dhe një të sharë personat brenda veturës që kishte thënë “nonën”, ashtu që kur kishte kthyer kokën e kishte parë të rrëzuar në tokë kolegun e tij të dëmtuarin A. O. i cili në ato momente kishte bërë titur “*ndal ndal*” e më pas i njëjti ishte nisur në drejtim të veturat i cili kishte ndaluar pas 10 – 12 metrave në mënyrë të vrullshme, ku i dëmtuari A. ishte ofruar tek vetura në fjalë dhe i kishte treguar se ata ishin zyrtar policor mirëpo nga vetura i akuzuari K. kishte sharë dhe kanosur në drejtim të dëmtuarëve ndërsa nga vetura kishte dalur i akuzuari M. M. i cili e kishte kapur për krahu të dëmtuarin S. dhe i kishte thënë “*unë ty po të njoh*”, dhe më pas kishin filluar sharjet dhe ofendimet ndaj zyrtarëve policor duke iu thënë përkatësisht i akuzuari Kelmend duke iu thënë “*jav qi policinë e nonës, na policisë së shkavit sja këna qi nanën e leje mo juve*” dhe më pas kishte dal nga vetura dhe kishte hipur mbi të duke tentuar që ti godiste të dëmtuarit por aty kishte dal edhe dëshmitari B. D. i cili e kishte kapur dhe e kishte futur përsëri në veturë, deklarata kjo që është në përputhje të plotë me deklaratën e të dëmtuarit tjetër A. O. i cili kishte deklaruar se pasi që fillimisht një veturë e kishte goditur me pasqyrën e veturës së tij, ai i kishte bërë me dorë që të ndalonin dhe pasi që vetura kishte ndaluar i akuzuari K. M. e kishte sharë me fjalë “*jav qi policinë e nonës, na policisë së shkavit sja këna qi nanën e leje mo juve*” edhe përkundër faktit se i dëmtuari i kishte prezantuar ID e zyrtarit policor të akuzuarit M. M. dhe në ato çaste ishte ofruar edhe i dëmtuari S. B. gjatë kësaj kohe i akuzuari M. M. i kishte thënë të dëmtuarit A. se atë nuk e njihje ndërsa të dëmtuarin tjetër S. i kishte thënë “*unë ty po të njoh*” dhe më pas i dëmtuari A. i kishte thënë të akuzuarit M. M. që ta fikte veturën dhe t’ia dorëzonte çelësat e veturës ndërsa i akuzuari K. M. kishte ndërhyrë duke i thënë të akuzuarit M. “*o bimi mu çelsat e une ia boj nonën i shkeli qutu*”, dhe kishte hipur mbi veturë duke tentuar ti sulmonte të njëjtit dhe me të parë këtë situatë i dëmtuari A. kishte kërkuar asistencë policore nga Stacioni Policor në Gjilan, e në ato momente e kishte parë kur i akuzuari M. M. e kishte kapur për duar të dëmtuarin S., deklarata këto që përputhen edhe me deklaratën e dëshmitarit B. D. të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor i cili mes tjerash kishte deklaruar se kishte qenë së bashku në veturë me të akuzuarit kur kishte ndodhur ngjarja dhe se “*...në momentin që po rritej tensioni ka dalë Kelmendi tani ka fol me polic dhe aty ka nis me u rrit tensioni...*”, po ashtu i njëjti në dëshminë e tij ka deklaruar se e ka dëgjuar të dëmtuarin S. i cili ka thënë “*...se unë jam polic*” dhe “*...unë e kam parë se M. është shtyer me të dëmtuarin S....*”, deklarata këto të cilat janë në harmoni edhe me dëshmitë e dëshmitarëve I. R., F. K. dhe E. G. të cilët ngjarjen e kanë treguar në mënyrë të njëjtë dhe në përputhje me njëra tjetrën ku kishin theksuar se natën kritike pasi që kishin pranuar thirrjen për asistencë nga të dëmtuarit, kishin shkuar në vendin e ngjarjes ku kishin evidentuar një numër të madh të qytetarëve të cilët kishin ndaluar për të shiquar konfrontimin i cili po ndodhte në mes të akuzuarve dhe të dëmtuarve dhe aty kishin parë të akuzuarit dhe të dëmtuarit të cilët ishin duke u shtyer fizikisht në mes vete dhe gjatë kësaj kohe të akuzuarit në vazhdimësi i kishin sharë të dëmtuarit ndërsa sipas dëshmitarit F. K. gjatë kësaj kohe ai e kishte parë të akuzuarin M. M. i cili ishte në cilësinë e shoferit të veturat kur e kishte shtyrë njërin nga policët e dëmtuar por nuk i kujtohet cilin sepse ngjarja kishte ndodhur shumë shkurt ndërsa sipas dëshmitarit I. R. të akuzuarit gjatë gjithë kohës i kanë kërcënuar të dëmtuarit me fjalë.

Duke pasur parasysh se forma themelore e kësaj vepre penale është sulmi apo kanosja serioze për sulmin ndaj personit zyrtar ndërsa veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale përfshin veprimin e shtyrjes së personit zyrtar, tërheqjen për krahësh të personit zyrtar si dhe kanosjen serioze se personi zyrtar do të sulmohet gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor

ngase nga provat materiale dhe personale të administruara nga ana e gjykatës është vërtetuar se gjatë konfrontimit në mes të akuzuarve dhe të dëmtuarëve ka pasur kanosje serioze për sulm ndaj personit zyrtar atëherë kur i akuzuari K. M. i drejtohet të akuzuarit M. M. me fjalët “*o bimi mu çelsat e une ia boj nonën i shkeli qetu*”, po ashtu është vërtetuar se natën kritike i akuzuari M. M. e kishte kapur për duar dhe e kishte shtyrë të dëmtuarin S. B. si dhe është vërtetuar fakti se nga sjelljet e të akuzuarve të dëmtuarëve u është bërë me dije se do të jenë të sulmuar në çdo çast dhe si rrjedhojë tek të njëjtit është shkaktuar ndjenja e frikës fakte këto që vërtetohen edhe nga deklaratat e të dëmtuarëve S. B. dhe A. O. si dhe deklaratat e dëshmitarëve I. R., F. K. dhe E. G. të cilët njëjtë kanë deklaruar se të akuzuarit kanë sharë, bërtitur, kapur për duarsh të dëmtuarin dhe kanosur me tone të larta të njëjtit gjithashtu ky konstatim gjen mbështetje të plotë edhe në provat materiale të administruara nga ana e gjykatës siç ishin raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-0757, deklaratat e të dëmtuarit A. O. e dhënë në prokurori me datë 27.07.2020, deklaratat e të dëmtuarit S. B. e dhënë në prokurori me datë 27.07.2020, raportet e policëve me datë 24.07.2020, CD-ja me video incizim, raportet e zyrtarëve policor I. R. dhe I. B., raporti mjekësor me numër të protokollit 16168 i datës 24.07.2020 në emër të A. O., foto dokumentacioni dhe rrjedhimisht duke u bazuar në të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet e veprës penale sulmi nga personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Sa i përket deklaratës së dëshmitarit I. B. gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e saj për faktin se sipas këtij dëshmitari i njëjti kur kishte arritur në vendin e ngjarjes të akuzuarit ishin prangosur dhe ai ishte i fundit që kishte mbërritur aty dhe rrjedhimisht deklarimi i tij nuk ka të bëjë me vërtetimin e gjendjes faktike por me veprimet operacionale që i ka ndër marrë si oficer policor.

Gjykata ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit M. M., të cilës mbrojtje nuk ia fali besimin ngase e njëjta në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të cilat gjykata i administroi gjatë kësaj procedure penale dhe të cilave ua fali besimin ndërsa i akuzuari K. M. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ishte mbrojtur në heshtje.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dëshmitarë në këtë çështje penalë juridike ka dëgjuar edhe dëshmitarët I. R., F. K. dhe E. G. të cilët si zyrtarë policor ishin të parët që kishin arritur në vendin e ngjarjes pas thirrjes për asistencë policore nga ana e të dëmtuarëve, oficeri I. R. kishte përpiluar raport me shkrim lidhur me këtë ngjarje dhe të njëjtit kishin bërë arrestimin e të akuzuarve.

4. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim që është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprën sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 402 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-ës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përkryerjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të njëjtit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarve duhet t’iu shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati

parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesve në të cilën përfshihet fakti se të njëjtit ka qenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre meqenëse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se të njëjtit kanë paraqitur një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor si dhe faktin këtë veprë e kanë kryer me dashje dhe atë direkte, gjykata pati parasysh edhe sjelljen e mëparshme të të akuzuarve ku nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se kjo ishte hera e parë që të akuzuarit bien ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për ndonjë veprë penale. Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarit mori rrethanat personale të tyre meqenëse të nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se kjo ishte hera e parë që të akuzuarit bien ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë si dhe sjelljen e tyre pas konfliktit meqenëse nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtit nuk kanë probleme me të dëmtuarit ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e tyre sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del të njëjtit këtë veprë penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte duke qenë të vetëdijshëm se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj ata kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprimet për kryerjen e kësaj veprë penale ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi gjithashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarit edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e të akuzuarve për kryerjen e veprave penale ngase të njëjtit edhe përkundër faktit se të dëmtuarit u kanë treguar se janë zyrtarë policor ata janë shfaqur agresivë, i kanë kanosur dhe shtyrë e edhe kapur për duarsh të dëmtuarit andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata të akuzuarve u shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarve mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Vendimi lidhur me llogaritjes e kohës së kaluar në arrest shtëpiak

Gjykata komfor nenit 79 të KPRK-ës, të akuzuarve të lartcekur kohën e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 24.07.2021 deri me datë 10.08.2020, ua llogariti në dënimin e shqiptuar me gjobë

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Të dëmtuarit A. O. dhe S. B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor kanë deklaruar se nuk parashetrojnë kërkesë pasurore juridike dhe rrjedhimisht gjykata nuk vendosi për të.

8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarve, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të secilin prej tyre veç e veç ti obligojë që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën

Numri i lëndës: 2020:088230
Datë: 17.06.2021
Numri i dokumentit: 01896390

prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.479/2020, me datë 17.06.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.